

BIBLIOTEKA

F

84-H18

L19

SHTELT

GJIROKASTËR



Natasha  
Lako

*E para  
fjalë  
e botës*

POEZI

8JH-1  
—  
219

Natasha  
Lako

*E para  
fjalë  
e botës*

POEZI



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## E PARA-FJALË E BOTËS

Eshtë fjala e thjeshtë «nënë»  
e para që shqiptojmë,  
dhe qesh ajo edhe rri zgjuar  
kudo që ne jetojmë.

Oh, nënë, nënë! Te trupi juaj  
fillon atdheu vetë,  
me emrin tuaj çdo foshnjë e vogël  
thërret gëzimin dhe jetën.

Dhe rritet, ngrihet hap pas hapi  
e para fjalë në botë,  
dhe emrin tënd Partisë ia japim, —  
gjithçka kjo do të thotë...

## VIZATIMI I PARË

Vizatimi i parë, më i thjeshti-dielli  
nën dorën e njomë të fëmijës.

Unë bëj një rrëth të artë  
brenda të cilit piqetjeta;  
rrezeni nxjerr fëmija imë,  
në fletoren e bardhë hyn drita.

Kështu krijofshi gjithnjë, gjenerata,  
diellin e madh më rreze të arta...

## KAM PËR TË SHKRUAR NJË VJERSHË PËR PRAGUN

Kam për të shkruar vjershë për pragun —  
të lëmuarin, të thjeshtin,  
E zënë erërat dhe s'e zënë dot,  
e zënë shirat, s'e zënë.

Asgjë nuk ulet dot në prag,  
gjithçka mbetet e lehtë,  
dhe kur shqiptari hedh një hap,  
atje hedh vallen vetë.

Kapërcyen aty legjendat dhe dasmat,  
vargjet dhe këngët e festës,  
po kurrë nuk shkeli hasmi  
në dy pëllëmbë të jetës...

## P O E Z I A

Tani mundohem të gjej  
cili është për këngën tingulli i parë:  
zhurma e hapave të mi në rrugicën e lagur,  
tringëllima e një pike shiu që kthehet në akull,  
fëshfërima e fletëve...

Jo, vjen më nga larg uturima e fjalëve;  
del më thellë,  
si fillimi i shqotës  
nga një dítë e nxeh të...

(Si zhurmë e betejës,  
nga prekja e metalit në linjë,  
e linjës me gjakun,  
kur nëna e dëshmorit vë në gjoks dekoratën.)

Kanë këngët e mia tingull të parë  
zhurmat e ashpra, betejat e fjalës,  
gjëmimin e komunistëve në nëntor 8,  
kur lindi jehona që rron përjetë.

Përcill, përcill jehonën e madhe,  
nga dheu plot hekur te kumbulla e bardhë,  
nga pikat e shiut te breshri i rrallë,  
nga sytë e mprehtë, te këmba e armës...

Vjen jehona e orës vendimtare,  
derdhet në shkronja, në abetare  
e lulet e të rënëve përcjellin jehonën e vjeshtës,  
nga petalet e kuqe në fletët e bardha të vjershës...

## **SYRI I KOHËS SIME**

1.

Një grusht vitesh...

Toka disa herë u rrrotullua rrreth diellit,  
Shqipëria ngrohu faqen e saj të bardhë...

2.

Jeta jonë  
ka pasur të rëndë  
si gurët e varrit  
500 vjet.

Një grusht vitesh hëngrën pesë shekuj, si ha deti  
kripën.

Një grusht vitesh me 500,  
një milion «me një mbret dyzet milionë»,  
një partizan me dhjetëra gjermanë,  
dhe plumb për armiqtë çdo sy dhe çdo gur, —  
një grusht vitesh që nuk arrin t'i numërosh kurrë.

(Orët diellore i bëmë sa vitet,  
pika e djersës lëviz si akrep...  
Vëllezër, motra,  
koha sa i japim, na jep.)

### 3.

Keni ndier si mblidhet bota në zemër,  
si rëndon kraharori nga gjaku që rrembat mbush;  
një shtrëngim nga ana e majtë,  
një gëzim nga shqetësimi i gjatë, —  
ja ç'është një grusht.

Po Shqipëria

ç'ndien në zemrën e saj,  
ç'mbledh më tepër se një bir?  
Në anën e majtë, në zemër, mban  
—komunizmin.

4.

Unë jam grua e zakonshme  
dhe për shtat më shkon çdo fjalë e mirë,  
mendimet m'i bluan  
zemra e Shqipërisë.

Asaj i sjell ditë e natë  
gjakun tim të kuq,  
emrin tim të pastër.

Dhe syri i kohës sime sheh më thellë,  
dhe syri i kohës sime sheh më gjatë, —  
pas rrjedhës së lumenjve të mi të rrëmbyer  
sheh dhe një tjetër të turbullt, të ngadaltë.

Lumë njerëzish,  
lumë ngjarjesh,  
orë të fundme të shekujve dembelë  
të zgjatur, të nxirë, të vyshkur, të prerë...

Kolerë, skamje, drogë  
grevëthyes, socialdemokratë dhe revizionistë,  
shoqëri ndërkombe  
hyjnë nëpër filtrin e kohës, —  
kullon djersa proletare.

Djersë njerëzore,  
e ngrohta, e shëllirta,  
që duan të të lëpijnë nëpërësira, —  
vetëm unë ta di shijen, vetëm unë të vë në ballë,  
të vë në turbina  
e krijoj hidrocentrale.

5.

Që koha të ngecë,  
që bota të mos njohë ligjet e jetës,  
ka klasa që duan të ndalin  
rrrotullimin e tokës rrreth diellit, —  
inkuizicion i tmerrshëm  
më i zi se shekuj me radhë.  
Po qindra herë më i fuqishëm se zëri i Galileut,  
zëri ynë ngrihet mbi malet e lartë.

6.

Jam mike e diellit,  
në rrezet e tij laj sytë, —  
fytyra ime e rrumbullakët,  
një diell i vogël i dytë.

Çdo ditë jona  
takohet me diellin ballë për ballë,  
pastaj lë tjetrën në vend të saj...

E mua më çel në kokë një ëndërr e re,  
(si ka ndodhur në ditën e parë të lirisë  
me nënrat dhe baballarët  
që pushkët i vajisën)  
një ëndërr e re  
që ua tregojnë nipave në fillim përrallë,  
që rritet  
në grusht vitesh.

## 7.

Mendimet bulojnë,  
bien dhe mbijnë në tokën e shtrenjtë,  
lëvizin qiejt,  
lëvizin fushat,  
lëvizin lumenjtë.

Si lumenjtë tanë të rrëmbyeshëm,  
sulet në botë drejt së vërtetës  
lumi i njerëzve të ndershëm.

Lumi i njerëzve që do të krijojë komunizmin-dritë,  
(si krijohen hidrocentralet  
nga rrjedha e ujërave të përditshme)  
lumi që kërkon të jetë i furishëm...

8.

Koha ikën,  
e unë qëndroj me diellin sy ndër sy,  
(veten s'e mas me diellin e mëngjesit).  
Trokët zemra ime në ditët që vijnë.

Një grua e zakonshme kam qenë në grusht vitesh,  
kam hipur dhe kam zbritur nga makina e Pila Le-  
res si udhëtarë,  
kam pirë qumështin e dhive të Lezanit,  
përcolla në dheun që lindi nënën Zeliha.

Njëri me tjetrin më lidhen muskujt e zemrës si  
kapriatat,  
tërhiqen si telat e tensionit të lartë,  
rëndohet kraharori nga gjaku i njerëzve,  
në anën e majtë.

Kështu eci  
 bashkë me heronjtë;  
 bashkë me ditët dhe vitet  
 eci dhe rritem.

Socializmi krahët e tij hap,  
 unë jetën time i jap.

Unë u kushtohem ditëve të tij,  
 fëmijët e mi për të i sjell, —  
 më i madh do të bëhet socializmi,  
 fëmijët e tij më të mëdhenj.

Shkojnë vitet,  
 shkojnë dhe nuk vijnë,  
 ne i përcjellim duke tundur shaminë...  
 Shkojnë ditët dhe kthehen përsëri, —  
 përballe diellit rri...

## E S O T M E

Rrugës eci  
me këngë në buzë,  
nxjerr nga xhepi  
bileta shumë.

Prapa tyre  
një vëllim me vjersha  
mund të shkruaja  
për rrugët ku eca.

Dhe përsëri  
do t'i mbush xhepat  
me këngë njerëzish  
dhe ritme trenash.

Për kë të mendohem  
kur këngët s'reshthen, —  
ja e djeshmja  
ja dhe e nesërmja...

SHALLO

Iliria  
Shqipëria  
Tyrkë  
Bashkimi i

## I L I R I A

Pas diellit që lindte  
mbretëresha Teutë  
**e sertë si era,**  
si era e butë.

Dhe ecnin dhe ecnin  
dy konsuj romakë  
Teutës i afroheshin,  
por diellit aspak.

Dy konsuj të ndritshëm  
perandorie,  
emblema e pushtimit  
e tyrja hije.



Po ç'është kështu  
anembanë?  
Teuta u shfaqet  
si tramundanë.

Mbrapsh, mbrapsh,  
mbrapsh sa më shpejt,  
tallaze ngre deti  
sa për mijra vjet.

Kush ndiell pushtimin  
kështu do të mbetet,  
një mur bëhet deti  
dhe toka si detet.

Dhe thonë së ikën,  
dhe thonë se u vrancë,  
nuk mban Iliria  
për ta as dhe varr.

E qetë Teuta  
më paskëtaj.  
...Dhe dielli më tej  
shkon mes trupit të saj.

## ZEMËRIMI I TEUTËS

Zemërimi i Teutës një agimi  
ia kalon zemërimit të Akilit.

Ai donte skllaven Brizeidë,  
ajo s'donte skllave Ilirinë.

Ai bir ishte perëndeshe,  
ajo mëmë kishte një tokë të qeshur.

Ajo zinte shkelësin e parë,  
ai linte një luftë të rrallë.

Ajo klithmë kishte edhe vrer,  
ai heshtje plot edhe verë.

Ajo çonte anembanë një alarm,  
ai priste trofera edhe ar.

Ai ngrihet në «Iliadën» e moçme,  
ajo shtrihet gjer në poemat e soçme.

## 28 NËNTOR 1912

Një jetë të tërë,  
flamurët, —  
ballët tanë të lartë.

Valvitet, valvitet  
një jetë të tërë  
ky ballë...

Frynen erërat,  
aty u mblodhën;  
ranë plumbat,  
aty u copëtuan;  
erdhën shqipet,  
aty u ulën.

Një popull i tërë  
shpalosi  
ballin e tij  
në hapësirë....

PARASHQEVI QIRIAZI  
NË KONFERENCËN E PAQES

*Paris, 1919*

Larg mbeti vatani,  
dielli mbeti larg.  
Nën një qiell tavani  
Parashqev' e ngratë.

Ç'janë këto bubullima,  
g'bëhet vallë vërtet?  
Thela Shqipërie  
dashkërkëa çdo shtet.

Këta plumba fjalësh  
varg seç i vijnë,  
«Copra toke ka,  
Shqipëri nuk dimë!»

— Zotërinj, pak prisni,  
Nemc a Itali,  
këmbët tuaja mbenë  
mu në Shqipëri.

E kush nuk e shkeli,  
kush s'e dogji vallë,  
çizmet e ushtrive  
mbledhur aty janë.

E degdisni vallë  
juve Shqipërinë,  
kur majat e këmbëve  
mbi marrëveshje rrinë?

— Oh, me një zonjushe  
krehur me kujdes  
mund të flasim ndryshe  
në koktej-ekspres.

Shqipërinë e bukur  
thua çuan larg?  
Ja ne po e fusim  
në tonin jatak.—

**Parashqev' e ngratë,  
Mihal, Gurakuq, —  
shırat hedhin valle,  
dielli gjak po skuq...**

## DRĒJT MËRGIMIT, 1936

Ecën, ecën, ecën, —  
për ku, për se?  
Toka rrugën të hapi,  
por vend pér varr s'ke.

Më e rëndë se vdekja,  
më e rëndë nga gjithçka,  
është kur në botë  
vend pér ty nuk ka.

Dhe ashtu tek ikën,  
puthjet rrinë në ballë.  
Të gjallë a të vdekur  
të përcjellin vallë?

U jam afruar të gjithëve  
duke ecur nëpër vite drite...

Dhe eci drejt shpirtit të popullit  
si ata që ecën drejt lirisë në male.  
E palodhur, në jetë të jetëve,  
në shpirtin e popullit ndalem!

## KJO VJESHTË

Kjo vjeshtë ka lidhje me trupin tim,  
se ndryshe si do ta ndieja veten të rëndë...  
Gjithë toka vjeshtake ndrin  
dhe mbi mua shtatzënën shtrydh lëng.

Erdhi tek unë kjo vjeshtë e plotë;  
e duket sikur sjell mençurinë njerëzore:  
kush pa njëherë fryt,  
për punë më të mirë mundohet!

Kjo vjeshtë ka lidhje me trupin tim,  
se ndryshe si do ta ndieja veten të lehtë...  
Zogjtë e vegjël në fluturim,  
ngatërrohen me fletët...

## MIRËMËNGJES!

Dielli ditën hap,  
ti, bijë, çel sytë si det,  
drita rrëth e qark  
të zgjon dhe të flet.

Eshtë dielli yt,  
është dielli im  
që ngrihet lart çdo ditë;  
në zemër rri,  
na hyn në sy  
drita e Shqipërisë.

«Mirëmëngjes!» të thonë  
punëtorët qëmenatë;  
toka të do fort,  
të rrit dhe të zgjat.

Një ditë shkon,  
një ditë vjen,  
nisim mëngjeset bashkë;  
dhe unë të jap,  
dhe ti më jep  
për atdhëun jetë.

## **UNË NUK KISHA SHKRUAR**

Unë nuk kisha shkruar as dy rreshta për time bijë  
kur në rrugë pas fishekzjarreve vraponin fëmijët.

Nëntori kish ardhur i madh dhe i bukur,  
ti ende s'njihje nënën dhe festat dhe kukllat.

Papritur, mes zhurmës, në dritaren tonë,  
si mik i padukshëm, ra një balonë.

Erdhën me vrap dhe e morën fëmijët  
balonën që të përkiste ty, bijë.

Gjithë zhurmat e festave edhe ty të takonin,  
dhe ngjyrat e qiellit që lëshonte balona.

Nëntori kish ardhur i madh dhe i bukur,  
ti ende s'njihje nënën dhe festat dhe kukllat.

Unë nuk kisha shkruar për ty as dy rreshta,  
sonte për ty u kujtuan dhé festat.

Shkruan e sot më

## **NINA-NANA**

**Eja, zog i vogël,  
eja, zog i vogël,  
fluturo nën qerpikët e vegjël.**

**Eja, lule e vogël,  
eja, lule e vogël,  
çel mbi qerpikët e vegjël.**

**Eja, zogu i vogël,  
eja, lule e vogël,  
hapësira është e madhe...**

## SHQIPËRIA

Shqipëria, lule e kuqe —  
edhe e çelur edhe burbuqe.

Shqipëria, zog shtrëngate —  
me zë bilbili, me krahë shkabe.

Shqipëria, këngë për trim —  
dhe nina-nanë edhe kushtrim...

## P È R V J E T O R È T

Vitet kalojnë,  
kalojnë përvjetorët,  
ditë me mijë...  
kemi të rënë  
28 000.

(Shkollat nxjerrin letrarë të rinj  
që gjithnjë do t'i këndojnë  
Margaritës syshkëndijë.)

Vitet kalojnë,  
vijnë përvjetorët, —  
në kujtesën e popullit,  
të rreshtuar, rrinë  
28 000.

(Cilin hero më shumë do ti?  
Qemalin a Vojon, Vojon a Qemalin —  
as unë s'e di!)

Vijnë përvjetorët:  
përfytyrime shokësh,  
takime brigadash,  
copëra këngësh,  
artikuj, data.

(Çdo përvjetor do të thonë fëmijët  
vjersha të reja  
për 28000.)

## MIRË SE ERDHËT, SHOKË TË DASHUR!

«Mirë se erdhët, shokë të dashur!»  
Kjo fjalë, e vënë në ballë të qytetit,  
që pret çlirimtarët pas kaq vjetësh,  
nga të gjitha është më e ngrohta,  
më e bukura.

Nuk ka fillim as fund kjo fjalë  
«Mirë se erdhët!».

Vijnë, vijnë, vijnë  
luftëtarët me flokë të thinjur,  
nuk ka ndarje, nuk ka largim.

## MISTO MAME

I vumë emrin tënd  
punishtes së parë  
ku blojtëm të paktë  
gjurin e mbjellë në luftë  
dhe të korrur pas saj.  
(Vende-vende nën tokë,  
ku ratë, e mbajtët ngrohtë.)

I vumë emrin tënd  
rrugicës së gjatë,  
ku ti more rrugën  
dhe kurrë s'u ktheve mbrapsh.

Edhe në shkollë doje që të lindte bota e tërë  
para syve të nxënësve të qetë, —

vumë në ballin e saj emrin tënd,  
sikur të thoshim:  
«Këtu mësohet e vërteta!»

Morëm zdrugun tënd  
dhe bëmë krevatin e parë në fabrikën e mobiljeve, —  
me këtë zdrug, si baba,  
do të bëje djepin e fëmijëve.

Tani rrugët i kemi më të gjera,  
tani po ngrehim furrnalta,  
po emri juaj më i madh  
ngrihet nga shkronja të zjarrita.

Mban njerëz jetë  
që si gjenerata kanë veprat.

## JORDAN MISJA NË FRASHTAN

Atë ditë asgjë nuk kapje dot  
nga fushat e lodhura përbri, —  
peneli yt s'i donte  
padrejtësitë.

Tani fusha të përtërrira,  
të bashkuara pa fund —  
duket që janë bërë të mira  
nga peneli yt.

Po ti s'lodhesh kurre  
dhe ndrron, ndrron çdo skaj,  
ti, piktor i jetës  
sot dhe paskëtaj.

## TEATER

E vutë re se si vrapuan  
dy vajza të reja, dy ushtare,  
plot pika shiu hynë brenda,  
dhe mushamatë dot s'i varën.

Në flokë dridhet një kordele,  
në duar dy biletat qullur,  
dhe s'mund të nisë një spektakël  
ato të dyja pa u ulur.

Më të bukurat, më të thjeshtat  
nga spektatorët e çdo ane,  
vijnë dhe sjellin nëpër rreshta,  
diçka ngajeta partizane.

## NËNA E DËSHMORES

Nëna e dëshmores

vazhdim të emrit të saj ka emrin e së bijës,  
si mali majën.

Gjeneratat një herë u kthyen mbrapsh  
kur vajza lindi nënën,  
si uji i pastër që pasqyron dhe dyfishon malin.

## TEATËR

E vutë re se si vrapuan  
dy vajza të reja, dy ushtare,  
plot pika shiu hynë brenda,  
dhe mushamatë dot s'i varën.

Në flokë dridhet një kordele,  
në duar dy biletat qullur,  
dhe s'mund të nisë një spektakël  
ato të dyja pa u ulur.

Më të bukurat, më të thjeshtat  
nga spektatorët e çdo ane,  
vijnë dhe sjellin nëpër rreshta,  
diçka nga jeta partizane.

## NËNA E DËSHMORES

Nëna e dëshmores

vazhdim të emrit të saj ka emrin e së bijës,  
si mali majën.

Gjeneratat një herë u kthyen mbrapsh  
kur vajza lindi nënën,  
si uji i pastër që pasqyron dhe dyfishon malin.

## V E T E R A N E S

Na duhesh si nënë, —  
ke marrë mjaltin e fjalës së tyre  
që vjen si dielli tokën të zërë.

Na duhesh si shok, —  
para teje e hap zemrën time,  
det bëhet zemra e vogël.

Na duhesh si bijë, —  
kush diti kaq mirë  
këngët e brezave në gjoks t'i përpjë?

Na duhesh si motër, —  
të shohim idealin e vëllait të rënë,  
të qeshurën e tij, shkallëzimin e flokëve...

Je nëna, shoku dhe bija shpalosur nga ëndrrat e një  
heroi  
që fle i qetë edhe në sytë e tu të qeshur.

—  
—  
—  
—

—  
—  
—  
—

—  
—  
—  
—

## GJEOGRAFIA E LUFTËS

Shokë, more shokë,  
që ndamë luftën si bukën, —  
shumë lumenj pamë  
në gjeografinë e luftës.

Njëri ishte i djersës,  
i dyti ishte prej gjaku,  
i treti me ujë të rrëmbyer,  
buzët e thara na lagu.

Njëri mal qe i gjerë,  
i ngushtë ishte tjetri, —  
një bojë njeriu i rritëm  
kur u ngjitëm përpjetë.

Shtigje me emra të rinj;  
ylli në çdo relief,  
emri i atij që ra  
në tokën përreth.

Kështu zbulon atdheu  
madhështinë e vet, —  
humbet dhe ngelet në rrugë  
gjeografinë e Luftës kush s'njeh...

## NGA LUFTA E MADHE MBARTËN MBI SUPE

Na ishin njëherë (se koha shkon shpejt)  
jo dhjetra, jo qindra, jo mijra...  
kondaku i pushkës së tyre  
përpara vu kokën me thinja.

Na ishin njëherë burra, fëmijë,  
të rinj, nuse, pleq mjekërbardhë...  
me plagë legjendash mes nesh

ata vijnë  
dhe plumba në trup mund të mbajnë.

Po t'i pyesësh të gjithë me radhë,  
do të thonë: «Asgjë s'kemi bërë të tepërt,  
megjithëse atëherë provonin mallë  
për gjumë dhe bukë me thekër...»

...Takimi me kohërat s'është i lehtë,  
po hapin në rrugë mund të mbani:  
meqenëse koha ecën gjithnjë e më shpejt,  
në vend të saj, ata ndalni...

## LART MË LART FLAMUJT E KONGRESEVE (këngë)

Me dyqind petrita, komunista lule,  
hapi Shqipëria historinë e kuqe.

Vitet ikin tutje, ne u ngjitëm lart,  
nga Thirrja e parë në Kongres të Shtatë.

Nëpër shtatë kongrese ne u bëmë si male,  
drita jonë e kuqe u bë dritë e madhe.

Para çdo stuhie, vetëtimë në botë,  
drita e Partisë zjarr edhe barot.

Na sjellin kongreset dritë dhe begati,  
syrin në shënjestër, nëna Shqipëri.

Lart më lart, o shokë, flamujt e Kongresit,  
beteja, fitore përpara na presin.

## P A G J U M E S I

Ra nata e kthjellët mbi qytetin e gjerë  
me trupin e saj të butë, të butë.  
Drurët e lartë bisedojnë me hënën,  
lulet prej gjumit kokën këputin.

Rrugët bëjnë gjumë asfalti  
dhe shohin në ëndërr hapat e nesërme,  
bie nga shtyllat drita e bardhë  
mbi gjethet e rëna dhe gjurmët e njerëzve.

Kjo e gjithë, qetësi nuk është,  
unë e di që njerëzit nuk flenë, —  
nëna të reja në bark rritin foshnja  
edhe në gjumin e tyre më të thellë.

## **MONOLOG I NJË GRUAJE**

**Me cilët sy të të shihja dashuri,  
me cilët sy?**

**Ishin vite të rëndë,  
duvaku na ngatërrrohej në këmbë.**

**Kishim shumë pér të hedhur,  
kishim shumë pér të ngritur,  
ashtu si nga errësira  
çohet dita papritur.**

**Prandaj zgjodhëm agimin,  
kohën që ndan gjithçka, —  
me dritën e tij  
krijuam sytë tanë...**

## **ME ZËRIN E KOHRAVE FLASIN...**

Unë kërkoj ditët  
dhe ec mes gjëzimeve njerëzore,  
koha më pëshpërit  
dhe shekujt më tundin dorën.

Mes vreshtave futem  
dhe ec mbi digën e gjerë,  
nga deti në majë ngjitem,  
më flasin gratë të tëra.

\* \* \*

Mëshova në gurë bedenash  
të bërë nga shkëmbi i bardhë,  
më thanë: «Këndejej ilirët  
u hodhën me radhë...»

Shkela mbi një shkëmb të fortë,  
më thënë: «Eshtë Shkëmbi i Vajës  
nga u hodhën krutanet  
dhe lirinë s'e dhanë...»

Shkela mbi një shkëmb të fortë,  
më thënë: «Eshtë Shkëmbi i suljoteve, —  
u hodhën me jetën  
lirinë për të mbrojtur...»

Atëherë kur mbi armiq  
nuk kishim ç'të hidhnik tjetër,  
në shekuj hodhëm vetveten  
në liri për të vdekur.

Ato që trupin hodhën  
dhe në skaje janë shpërndarë,  
ranë mbi gjithë këtë tokë,  
si në fushë çdo vit bie farë.

Dhe me zërin e kohrave flasin,  
me zërin e nderit të tokës,  
që kurrë s'e kërrusi shpinën  
dhe kurrë s'e uli kokën.

## DHE ASHTU U RRITËM

...Dhe ashtu u rritëm të ujitura me lotë,  
lotët më të hidhur, më të kripur në botë.

Jeta na thoshte:

të qani,

nëna na thoshte:

të qani,

mblesi na thoshte:

të qani,—

të qani, të qani

kur të kaloni pragun e portës!...

Preva rrugët e lotëve,  
lotët i mbledha në pëllëmbët e mia.

Cilët dilnin prej fjalëve të nënës,  
cilët dilnin prej fjalëve të mblesit,—  
të qani, të qani...

se për vashërinë dhe një grusht lirie,  
do t'ju marrë malli.

Kush ishte liria?  
Mos duhej ta gjeja në pëllëmbët e mia?

Të pastroja lotët  
dhe të gjeja një pikë të vetme-veten,  
të pastroja lotët  
dhe të thaja tokën.

Se toka ime  
jetonte përjetësisht  
bashkë me mua që do të vija.

Toka ime  
dhe trupi im  
në ëndërr lirie të shkrira...

Toka ime,  
kur tē shponin ty,  
gjaku rridhte nga plagët e mia,  
kur më suleshin mua,  
trupi ty tē bëhej me vija.

Plagët na i lidhi një dorë e madhe,  
plagët na u zhdukën kur u hodhëm në grykë tē  
topit.

Tokë e rilindur, ti më lulëzove  
me lirinë tënde dhe lirinë e popullit...

## KATËR HEROINAT E MIRDITËS

Martë, Shkurtë, Prenë edhe Mrikë  
gjithnjë sikur na rrinë nën qerpike.

Për secilën, ata zgjodhën nga një natë  
derisa papritur vranë katër.

U copëtuan nga armiqjtë katër net,  
mëngjeset ishin katër, katër mbetën.

Dhe papritur u bënë bashkë katër ditë —  
edhe plumbat, kur u ranë, nxorën dritë.

Kaq shumë njëra-tjetrës pranë e pranë, —  
porsi krahë horizonti, katër anë.

Dhe ngado që shkojmë, ngado vemë  
katër krahë horizonti ato gjejmë.

## KONGRESET E BASHKIMIT TË GRAVE

Disa herë jemi nisur për rrugë  
për t'u takuar bashkë, —  
që kur nisëm të hapnim sytë  
dhe pushkën e kishim në krah.

Dësa herë jemi mbledhur  
për të gjetur njëra-tjetren;  
në sulm për dritën e jetës  
të gjenim, të njihnim dhe veten.

Dhe prapë e gjetëm kur morëm  
diçka nga drita e Razës,  
diçka nga zemra e Gjystes,  
diçka nga çdo delegate.

Pas çdo rruge jemi ulur  
një çast bashkë me Partinë,  
nga grushti i saj të pimë ujë  
dhe djersën tonë të fshijmë,

që prapë rrugën të nisim  
drejt shtigjeve të reja që feksin,  
agimin e ditëve të reja  
me duart tona të ndezim.

## NJË KËNGË PËR KONGRESIN E NËNAVE

Mblidhi, mblidhi,  
mblidhi, fëmijë,  
ku fletët flasin  
dhe fjalët mbijnë.

Sillni të gjithë  
ju nga një shkronjë,  
të madhen këngë  
ne ta ndërtojmë.

Bebi i vogël,  
që qan çdo ditë,  
le të mbajë  
shenjëzën pikë.

Fjali të gjata  
le të na sjellë  
ai që matet  
me ndonjë pemë.

(Fjala e gjatë,  
emancipim,  
vinça kërkon  
siç çdo shpjegim.)

Kënga jonë  
shpejt do mbaruar,  
ende Kongresi  
sa s'ka filluar.

Ju e dini  
ç'do të thotë kongres...  
Ja, lule mblidhni,  
fushës përreth.

Dyzë nga dyzë  
dhe njëzë nga një,  
tufën me lule  
dora s'ua nxë.

Lule tē bardha  
đhe lule alle,  
do tē hyjnë nënat  
në sallën e madhe.

A e dini  
se kush i mbledh?  
Dora e Partisë,  
dielli pérreth.

Dritë nëpër sy  
sa shumë që kemi, —  
këtej korrim këngën,  
këtej e mbjellim...

Mblidhi, mblidhi,  
mblidhi, fëmijë,  
ku fletët flasin  
dhe lulet mbijnë.

## NË KANTIERIN E MADH

Në kantierin e madh nuk më zë gjumi natën...  
Dal dhe pres dritat e tij në kraharorin e gjerë,  
dal dhe kap zhurmat e tij me dorë të shkathët.  
Nina-ħana e tij thotë: «Mos fli,  
dhe kur tē flesh, bëj gjumin që te unë sot  
bën hidrocentrali i ardhshëm...»

## BASHKIMI I VALBONËS ME DRININ

Rrjedhë shekullore e Drinit të turbullt,  
lëvize,  
buçite si në suferinë  
për të dhënë dritë,  
pastaj pushove...  
Ballin e dirsur ta fshiu Valbona,  
Valbona e qashtër që humbi vetveten  
për të dhënë dritë  
në rrjedhën që ikën  
në të tjera prita...

## NJERÉZIT E MI

Užiccaha svetlipsa mi  
zemska kultura. Minu egi stol  
česna ponja. Njerézit e vrellshem  
zemrén ma hapén,

Užiccaha svetlipsa mi  
njerézit e bukur  
zemrén ma skuqén,

Užiccaha svetlipsa mi  
njerézit e zgjuar  
zemrén ma zgjuar.  
Hedha i Šri qitara ñeguqtik  
ñinofol öjerga ës ob haxaq  
Zemrás sona. Apa ke kifirja. Leku  
lule tē shekujve.

Užiccaha svetlipsa mi  
njerézit e bukur  
zemrén ma hapén.

## KUR KAPËRCEVA LUSHNJËN IM I TISNIAT

Kur kapërceva Lushnjën  
gjeta një fushë me grurin e hedhur,  
një shtyllë tensioni të lartë me rrënje nën grurë.

Atje erdhi lejleku,  
mbërtheu kthetrat e tij në hekurin që përcjell  
dritën si erën.

Lejleku i fushës sime  
që do të presë  
derisa fshatarët me diellin  
të kthejnë grurin në kashtë;  
pastaj do të ngrejë folenë,  
gëzimin e punës në sqepin, e artë,

Kur kapërceva Lushnjën,  
gjeta një vend të dashur  
ku fluturonte lejleku, përcillej era dhe drita...

## RRUGA E PRANVERËS PËR NË KORÇË

Me hap të lehtë, duke u dridhur,  
e mbushur më ujra të shkrira,  
shfaqet pranvera fare papritur  
në viset e mia.

Ashtu e madhe, gjoksin ka ngrohur  
në oxhaqe fabrikash dhë zjarre,  
veshur me këmi shën gholle të pemëve  
s'ka ndodhur të vijë nga asfaltetë sq i sijë

Ajo ka rrugë të gjatë, të paanë,  
në male, kur qjetet përhershëm  
Rruga ime drejt vendlindjes  
është rruga e pranverës, është rruga e pranverës,

## PAS KORRJEVÉ, NATËN

Pashë një djalë dhe një vajzë  
pas korrjes, natën, —  
të dy të rëndë sì kallinj,  
të dy me drapër...

Vajza vuri draprin në sup,  
draprin e veshur me hënë;  
djali pa supin e saj, —  
hëna kishte rënë.

Pashë një djalë dhe një vajzë  
pas korrjes, natën,  
të dy me flokë të përdjellur,  
të dy me drapër...

Djalit i rà një copë diell,  
ose nga gruri i pjekur,  
ose nga flökët e përdjellur.

Vajza pa sytë e tij,  
dhe ndjeu në zemër një drapër...

THE MARCH OF TIME

• 100 •

卷之三

1000

10 of 10

卷之三

Wald-Ortschaften

Dikur e qepet epi si i tijet  
...mëtëro i fitorë sëpët epi  
mëllështëq i tafotë sëpët epi

...jt e shëve qip epi  
...mëpshët qip mëtës qip mëtës epi

## PAS SHIRJES, NATËN

Diku

telat e mbështjellë të bakrit  
(ngjyrën e grurit të pjekur kanë në brendësi)  
përcjellin sinjalët e zërit tënd.

Dita këputet e ndritshme në horizont  
(është ora kur fëmijët përkulin gjunjët në krevat  
e bien të flenë).

Lajmëthirrja jote nga pyjet  
në fushë më vjen si fëshfërimë...

(Diku

një receptor ngjan papritur  
zog që çukit sinjale të shkoqura gëzimi  
si kokrra drithi.)

Sonte hapësira e madhe na lidh  
më shumë se çdo shpikje komunikimi...

Ellekut i përfshinë këtë vëllim që  
kam zvogëluar përmes një tregimtarit e parë  
menjë pëq qëndrueshëm do është që  
dhergjet që do rritet  
Naturkëpçit,  
kam lënë moli tregxënë që do bëhet e ikuq  
tregxën e puke së është përbërë t' u shpëtuar  
shtigjatuese që pëngjyrët e tregxën

U li gjallprurët që tregxën  
në kushtet e tregxënët vaskëpëdhimit  
heqja e tregxënës përgjithësia e shtigjeve  
shtigje që pëngjyrët e tregxënët...

SHIGA  
SHIGA  
SHIGA  
SHIGA  
SHIGA

SHIGA  
**URIMI I PUNETOKEVE**

Elektricisti,  
kur vuri portollambën në tavanin e bardhë,  
mendoi për dritën që do të derdhet çdo natë.

Zdrukthëtari,  
kur lëmoi tryezën në dorën e fundit,  
tryezën e bukës që është bërë për t'u shtruar,  
tha lamtumirë dhe punë të mbarë.

Uji gjithnjë të rrjedhë,  
në karrige njerëzit vazhdimisht të rrinë,  
dera të këndojej këngën e ziles,  
çdo gjë të punojë pa pushim...

## KËNGËT TONA

Këshitu vijnë këngët tonat  
si mjalti nga lulet e njomave  
Jeta qenka si lehona,  
pikon qumësht dhe rrjedha e  
nga ditët që kemi përreth...

Dhe unë vete e mbledh...  
Këshitu vijnë këngët tonat  
si mjalti nga lulet e njomave  
Jeta qenka si lehona,  
pikon qumësht dhe rrjedha e  
nga ditët që kemi përreth...

Shkruan e shkruan e  
shkruan e shkruan e  
shkruan e shkruan e  
shkruan e shkruan e  
shkruan e shkruan e

## LIRIKË TIRANASE

Ditë e pastër, hyjnë në shpirtin, tim,  
ajri i qelqtë, i tejdukshëm,

rrugës vajza, të mira,

më sy, më të departueshëm,

Kush e bëri këtë ditë të bukur,

vajzat e thjeshta apo ajri,

cicërrimat e zogjve nga ballkonet  
bëjnë të ditës tik-takun.

Kjo ditë është e bardhë,  
nuk pranon dhe njollën e qiellit,  
deri në thellësi të zemrës  
lëkundet ajri i qelqtë.

Me sajë që dëshiron  
qëndrueshëm këtë  
së përcjellë  
dëgë së

**NË KORRIDOR**  
një lëvizje e çdo shqipëtardit  
që nuk ka qetësi që tashmë  
nuk bënë o një korridor.  
(Për 41 vjetët që është midisfërdës  
Vetëm një varëse në korridor.  
Atje në çdo stinë  
një plaçkë që tregon udhët varet,  
(Ne të dy gjithmonë  
aty ngatërrojmë shallet.)

Ti drejt meje vjen  
herë i lagur nga qielli,  
herë i lyer nga balta, —  
unë i ndiej që larg  
kollën tënde dhe hapat.

Pastaj më pikon shiu yt në ballë  
(fytyra jote bëhet qiell),—  
ka një sekondë të madhe,  
ka një sekondë në korridor,  
që tregon udhët dhe ndarjet.

Me asnje çast dashurie  
s'mund ta këmbesh këtë:  
as heshtje  
as zë.

Mblidhet diçka nga malli i njerëzve,  
mblidhet diçka nga e jetës hareja  
në korridorin nga nisin rrugët e mëdha  
në shërbim të ditëve të reja.

MIKROFONI DILBER BAKA  
INTERVJU  
LINDA FERD  
INTERVJU  
LINDA FERD  
INTERVJU

MIKROFONI DILBER  
MIKROFONI DILBER  
MIKROFONI DILBER  
MIKROFONI DILBER

MIKROFONI DILBER  
MIKROFONI DILBER  
MIKROFONI DILBER  
MIKROFONI DILBER  
MIKROFONI DILBER

## FËMIJËT E SHQIPËRISË (këngë)

Si lule maji jemi ne,  
si zogj që cicërojmë;  
i madh atdheu, të vegjël ne  
po nisim rrugën tonë.

Ne madhështinë e Shqipërisë  
e ndiejmë në çdo hap,  
me dashuri dora e Partisë  
të ardhmen po na hap.

Ne mbledhim rreze dhe dashuri  
në tokën tonë të shtrenjtë,  
në këngën tonë për ty atdhe  
pranvera vjen përjetë.

Pranvera e Shqipërisë  
në tokë vjen, në qiell të ri,  
drita e diellit të Partisë  
na jep ne jet' dhe fluturim

## VJESHTË E TIRANËS

Nata është ndarë  
në katrорë drite, —  
ndizen dritare,  
dritare fiken.

Pemët vjeshtore  
mbeten zhveshur,  
hëna e artë,  
e vetmja gjethe.

Në trotuare  
të dashuruarit  
në trungje peme  
mbështetin duart.

O sa tē sigurt  
janë tē gjithë  
kur vjeshtë e tërë  
mbi ta lëviz.

Mbi kokën time,  
mbi kokën tënde,  
qesh natë e ngrohtë  
me buzë hënë...

Ми  
Ми  
Ми  
Ми

Ми  
Ми  
Ми  
Ми

Ми  
Ми  
Ми  
Ми  
Ми  
Ми  
Ми

## O R A

Ora. Ora. Ora.

Zgjatet Tirana nën të

tik — tak.

Tymi i luftës i djeg sytë akoma,  
ngjyra e të derdhurit gjak..

Ora. Ora. Ora.

Mijra sy mbi të nga çdo skaj.

Ngado që të jesh, një kthim koke drejt saj.

Të dashuruar,  
kalimtarë,  
të lumturuar, —  
në jetë u ka dhënë diçka;  
një çast i pahruar,  
ja, pikoi dhe ra.

Kjo s'është orë me buf,  
dhe me pendul të madh,  
poshtë koha lëviz, —  
njerëz, taksi, urbanë.

Në qoftë se ndonjëherë lodhet,  
(thellë ajo e di vetë)  
nga indiferenca trishtohet  
